VENDIM
Nr. 339, datë 4.5.2016

PËR KRIJIMIN E MUZEUT KOMBËTAR TË FOTOGRAFISË "MARUBI" DHE PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË GODINËS E TË INVENTARIT TË MJETEVE KRYESORE TË FOTOTEKËS KOMBËTARE "MARUBI" NGA MINISTRIA E KULTURËS TE KY MUZE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1 e 12, pika 3, të ligjit nr. 9386, datë 4.3.2005, "Për muzetë", të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e shtetit për vitin 2016", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi", me seli në Shkodër, si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Kulturës.
2. Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" ushtron veprimtarinë e tij si institucion i specializuar muzeor, arkivor në fushën e fotografisë.
3. Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" ka të drejtë të krijojë fondacione në bashkëpunim me entitete të tjera juridike, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kalimin në përgjegjësi administrimi të godinës e të inventarit të mjeteve kryesore të Fototekës Kombëtare "Marubi", nga Ministria e Kulturës te Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi".
5. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi' miratohen me urdhër të Kryeministrit.
6. Fondet për realizimin e shpenzimeve, si dhe numri i punonjësve të miratuar për buxhetin e vitin 2016, për Fototekën Kombëtare "Marubi" i kalojnë Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi".
7. Numri i punonjësve të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi" bëhet 10 veta.
8. Numri i punonjësve rezervë, i parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit, reduktohet me 5 veta, duke e çuar numrin rezervë të punonjësve në 24 veta.

9. Në programin "Trashëgimi", të grupit buxhetor "Ministria e Kulturës", në buxhetin e miratuar për vitin 2016, shtohet fondi prej 3 669 000 (tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", për Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi".
10. Fondi i shtuar sipas pikës 9, në shumën 3 669 000 (tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
11. Vendimi nr. 849, datë 19.12.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për funksionimin e Fototekës Kombëtare "Marubi" dhe për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Bashkia e Shkodrës Ministrisë së Kulturës", i ndryshuar, revokohet.
12. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama